

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 7002  
E premte, 22 shtator 2023  
Çmimi 0.40

Osmani  
takohet me  
Bidenin:  
Themelet e  
lirisë dhe  
shtetësisë së  
Kosovës  
janë në  
aleancën e  
përherëshme  
me ShBA-në



FAQE 2

Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

INTERVISTË E GABRIEL ESCOBARIT PËR "ZËRIN E AMERIKËS" | FAQE 4-5

## QEVERIA KURTI E KA MARRË DIALOGUN VETËM ME 'PO-JO', ËSHTË KOHA TË NDRYSHOJË QASJE



I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës dhe kryeministrin Albin Kurti për, siç ka thënë ai, se e ka marrë dialogun si një opsion vetëm "po apo jo". Ai ka thënë se një vend prej 1.5 milionësh nuk mund t'i bindë t'i ndryshojnë taktikat e dialogut. "Nuk mendoj se një vend prej një milion e gjysmë do ta bindë komunitetin transatlantik prej 700 milionësh që t'i ndryshojë taktikat e tij. Mendoj se duhet të ketë një përqasje më pragmatike nga Qeveria e Kosovës", ka thënë ai. Escobari ka shtuar se ShBA-ja e mbështet BE-në si ndërmjetësuese të dialogut. Në këtë kontekst, ai ka thënë se emisari i BE-së për dialogun e ka përkrahjen e BE-së dhe se nuk do të largohet nga kjo pozitë. Ai ka thënë se ka kërkuar nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Kurti t'i dënojnë sulmet ndaj Lajçakut

RAMA NË  
KËSHILLIN  
E SIGURIMIT  
MBRON  
KOSOVËN  
DHE  
UKRAINËN



FAQE 7

PRESIDENTI I  
KROACISË NË  
OKB BËN  
THIRRJE PËR  
NJOHJEN  
UNIVERSALE  
TË KOSOVËS



FAQE 3

LUGINA E PRESHEVËS SË SHPEJTI  
DO TË BËHET ME PLAN TË  
FIZIBILITETIT EKONOMIK | F. 8

SPORT



EJUPI LARGOHET PAS 20 VJETËSH  
NGA FC PRISHTINA, HARADINI  
ZGJEDHET PRESIDENT I RI | F. 12

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
+389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)



NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Osmani takohet me Bidenin: Themelet e lirisë dhe shtetësisë së Kosovës janë në aleancën e përhershme me ShBA-në

NJU-JORK, 21 SHTATOR - Presidentja e Republikës së Kosovës, Vjosa Osmani, e cila po qëndron në Nju-Jork ku po mbahet sesioni i 78 i Asamblesë së Kombeve të Bashkuara, ka marrë pjesë në pritjen zyrtare të organizuar nga presidenti i ShBA-së, Joe Biden. Në një bashkëbisedim të ngrohtë me presidentin Biden, presidentja Osmani ka theksuar se në themelet e lirisë dhe

shtetësisë së Kosovës është aleanca e përhershme me ShBA-në.

Në këtë kontekst, ajo ka përsëritur qëndrimin se partneriteti me Amerikën është ekzistencial, i pacenueshëm dhe i pazëvendësueshëm. Po ashtu, presidentja Osmani ka pasur mundësinë ta njoftojë presidentin Biden për zhvillimet e fundit dhe sfidat me të cilat po ballafaqohet



Kosova. Pas këtij bashkëbisedimi, presidentja Osmani ka theksuar se ka marrë garanci të fuqishme

nga presidenti Biden për mbështetjen e vazhdueshme amerikane ndaj Kosovës. Osmani e ka falënderuar

presidentin Biden për ndihmën të cilën vazhdimisht e jep ShBA-ja për Kosovën në rrugën e drejt stabilitetit dhe zhvillimit.

## Mbi 40 mijë të zhvendosur si pasojë e vërshimeve në Libi

Tripli, 21 shtator - Nga vërshimet në Libi që kanë vrarë mijëra persona që qytetin Derna janë zhvendosur mbi 43 mijë persona. Kështu ka bërë me dije Organizata Ndërkombëtare për Migrim. Vërshimet kanë shkatërruar dy diga në Derna më 10 shtator, duke shkatërruar lagje dhe shumë shtëpi. Shifrat zyrtare e të vdekurve është mbi 3 mijë e 300, por grupet ndërkombëtare të ndihmës kanë thënë se numri pritet të rritet pasi vlerësojnë se deri në 10 mijë



persona konsiderohen të zhdukur. "43 059 persona janë zhvendosur si pasojë e

shtuar se "mungesa e furnizimeve me ujë ka shtyrë shumë persona të zhvendosen nga Derna" për në zona të tjera.

Banorët në këto zona, sipas kësaj organizate, kanë nevojë "për ushqim, ujë të pijshëm", por edhe përkujdesje për shëndetin mendor.

Gjatë javës Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar se përhapja e sëmundjeve mund të sjellë "një krizë të dytë shkatërruese" në zonat e goditura nga vërshimet. Zyrtarët lokalë, agjencitë e

ndihmës dhe Organizata Botërore e Shëndetësisë "janë të shqetësuara lidhur me rrezikun e shpërthimit të sëmundjeve, veçmas të sëmundjeve që shkaktohen nga uji i kontaminuar", kanë thënë Kombet e Bashkuara.

Qendra për Kontrollin e Sëmundjeve në Libi ka paralajmëruar se në zonat e prekura nga vërshimet uji vazhdon të jetë i ndotur, duke u bërë thirrje qytetarëve të mos e përdorin për pije.

## Rusia kryen sulm masiv ndaj infrastrukturës së energjisë në Ukrainë



KIEV, 21 SHTATOR - Rusia ka kryer një prej sulmeve më të mëdha me raketa që javët e fundit kanë goditur Ukrainën, duke goditur ndërtesa të energjisë. Si pasojë e sulmeve është raportuar për ndërprerje të energjisë elektrike në pesë rajone ukrainase, duke ua kthyer në kujtesë ukrainasve sulmet gjatë dimrit të kaluar, që shkaktojnë dëme të mëdha në infrastrukturë dhe lanë pa energji miliona banorë.

Zyrtarët kanë thënë se të paktën 18 persona janë plagosur nga

sulmet ajrore, përfshirë edhe një vajzë nëntëvjeçare, ndërkaq një guvernator rajonal tha se dy persona janë vrarë nga granatimet gjatë natës. "Dimri po vjen. Sot Rusia rinisi sulmet me raketa ndaj infrastrukturës energjetike të Ukrainës", ka njoftuar ligjvënësi Andrii Osadchuk.

Operatori i energjisë në Ukrainë, "Ukrenergo", ka thënë se këto ishin sulmet e para ruse ndaj infrastrukturës së energjisë në gjashtë muaj. Operatori ka thënë se ka dëme në ndërtesat e

energjisë në rajonet perëndimore dhe qendrore.

Ukraina për muaj të tërë ka riparuar infrastrukturën që është dëmtuar gjatë sulmeve në dimrin e kaluar, pasi pothuajse gjysma e sistemit të energjisë së shtetit është shkatërruar nga sulmet e Moskës. Ukraina në qershor ka nisur një kundërofensivë ndaj forcave ruse, të cilat nisën pushtimin në shkurt të vitit 2022. Kundërsulmi ukrainas në lindje dhe jug është duke shkuar më ngadalë sesa pritej.

## Ukraina dhe Polonia arrijnë marrëveshje për politikën e eksportit të mallrave

KIEV, 21 SHTATOR - Ukraina dhe Polonia kanë rënë dakord sa i përket bashkëpunimit në fushën e politikës së eksportit, ka njoftuar Ministria e Bujqësisë e Ukrainës. Në njoftim është thënë se marrëveshja është arritur gjatë një bisede telefonike mes ministrit ukrainas të Politikës Agrare dhe Ushqimit, Mykola Solska dhe ministrit polak të Bujqësisë, Robert

Tellus. "Solska foli me kolegun e tij polak Robert Tellus. Ministrat diskutuan për situatën si dhe për propozimin e Ukrainës për një zgjidhje dhe ranë dakord për të gjetur një zgjidhje që do t'i merrte parasysh interesat e dy vendeve. Palët ranë dakord të zhvillojnë një opsion për bashkëpunim në çështjet e eksportit në të ardhmen e afërt", është thënë në njoftim.

Komisioni Evropian ka njoftuar se do ta heqë ndalimin e importit të drithit nga Ukraina në pesë vende anëtare të BE-së.

Polonia, Hungaria dhe Sllovakia më pas kanë njoftuar se do ta zgjasin në mënyrë të njëanshme ndalimin, kurse Kievi paraqiti një ankesë në Organizatën Botërore të Tregtisë kundër Varshavës, Budapestit dhe Bratislavës.



# Rama në Këshillin e Sigurimit mbron Kosovën dhe Ukrainën

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka drejtuar një nga seancat më të rëndësishme të dekadës së fundit në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, në të cilën është diskutuar për luftën në Ukrainë. Kjo mbledhje është përcjell me polemika në mes të Shqipërisë dhe Rusisë për shkak të pranisë së presidentit ukrainas, Volodymyr Zelensky. Rama i ka thënë ambasadorit rus në OKB, Vassily Nebenzia, që Rusia ta ndalë luftën në Ukrainë dhe Zelensky nuk do të flasë në Këshillin e Sigurimit. Polemikë nuk kanë përfunduar me kaq, pasi Rama ia ka nxjerrë kartën e OKB-së delegacionit rus, duke i thënë se “sado që përpiqeni, Kosova është e pavarur”

EPOKA  
ERE

Lirim GECI

**NJU-JORK, 21 SHTATOR** - Mbledhja e Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), e cila është drejtuar nga kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, është përqendruar te lufta në Ukrainë. Kjo mbledhje është përcjell me polemika nga Rusia, Shqipëria, kryetare e radhës e Këshillit dhe Ukraina.

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, që ka drejtuar seancën, e kishte ftuar presidentin ukrainas, Volodymyr Zelensky, të fliste. Ishte hera e parë që presidenti ukrainas merrte pjesë personalisht në punimet e këtij organi të OKB-së që kur Moskë ka nisur agresionin ndaj Ukrainës në shkurt 2022. Por edhe para se Zelensky ta merrte fjalën, ambasadori rus në OKB, Vassily Nebenzia dhe kryeministri Rama kanë këmbyer polemika të ashpra.

Rusia ka shprehur pakënaqësinë për pjesëmarrjen e presidentit Zelensky dhe faktin që ai ka folur para se të flisnin anëtarët e Këshillit të Sigurimit.

Ambasadori Nebenzia ka thënë se Shqipëria kishte shkelur gjithashtu rregullat, duke ftuar një numër të madh përkrahësish (të Ukrainës) nga vende të NATO-s, si dhe ministrin e Jashtëm të Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, si kreun e radhës së OSBE-së.

Kryeministri Rama është përgjigjur me ironi se “ky nuk është një operacion special i presidencës shqiptare”, një

referencë ndaj emërimit të Rusisë për ofensivën e saj kundër Ukrainës. “Na vjen keq që Presidenca shqiptare po tregon një shpërfillje të hapur për praktikën për konsensus të Këshillit të Sigurimit. Ata po vendosin bindjet e tyre politike dhe ideologjike të NATO-s, mbi detyrimet e Këshillit të Sigurimit, që përcaktojnë procedurat dhe duhet të mbajë një qëndrim të paanshëm. Për fat të keq, Shqipëria nuk arriti ta bëjë një gjë të tillë sot”, ka thënë ambasadori Nebenzia.

Ndërsa kryeministri Rama ka reaguar ashpër, duke thënë se i



dukej interesante që Rusia jepte leksione për shkeljen e rregullave. “Por duke qenë se ju përsëritet shumë herë se shkelja ka të bëjë me faktin që presidenti Zelensky të flasë më parë se anëtarët e Këshillit, ka një zgjidhje për këtë, nëse ju bini dakord. Ju ndaleni luftën dhe presidenti Zelensky nuk e merr fjalën. Ajo që e bën atë të rëndësishëm këtu dhe ajo që e bën të rëndësishme për të gjithë ne që ta dëgjojmë atë fillimisht dhe pastaj të diskutojmë, është shkaktuar nga ju, jo nga ne”, ka

thënë ai. Pas përfundimit të kësaj seance, presidenti Zelensky e ka falënderuar Ramën në platformën “X” për mbështetjen në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. “I dashur Edi Rama, sot në Këshillin e Sigurimit të OKB-së ju i treguat botës se si ta trajtojë ashtu siç duhet Rusinë, gënjeshtër dhe hipokrizinë e saj. Ju falënderoj që e drejtoni Presidencën në një mënyrë kaq parimore”, ka shkruar Zelensky.

Në fjalën e tij para Këshillit, Zelensky ka thënë se nuk do të kishte ardhur në mbledhjen e Këshillit nëse nuk do të kishte një propozim për t'i dhënë fund luftës 19-mujore. Ai ka thënë se rikthimi i të gjithë territorit nën kontrollin e Ukrainës është çelësi për paqen. Para mbledhjes së Këshillit të Sigurimit, kryeministri Rama ka folur për domosdoshmërinë e mbështetjes së Ukrainës. “Ta ndihmohet Ukrainën sot të vetëmbrohet duke frenuar Rusinë, përçon mesazhin më të drejtë dhe të mirë tek gjithkush që mendon të angazhohet në një aventurë të ngjashme nesër, jep garanci për ata që kërkojnë paqe dhe bashkëpunim, paralajmëron ata që duan konfliktin dhe përplasje, sepse nëse agresioni do të kishte sukses, kjo do ta përçonte sinjalin e fundit të botës siç e njohim sot”, ka thënë Rama.

Shqipëria ka marrë për herë të dytë drejtimin e Këshillit të Sigurimit dhe pasojat e agresionit rus të Ukrainës te paqja dhe siguria në botë janë në qendër të agjendës së saj.



## Rama me Zelenskyn nënshkruajnë deklaratë për mbështetjen e pakushtëzuar të Ukrainës

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka nënshkruar deklaratë të përbashkët me presidentin e Ukrainës, Volodymyr Zelensky, për mbështetjen e pakushtëzuar të Ukrainës. Kjo deklaratë është nënshkruar në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju-Jork të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. “Selia e OKB-së, Nju-Jork – Nënshkrimi i deklaratës së përbashkët me presidentin Volodymyr Zelensky për mbështetjen e pakushtëzuar të Ukrainës”, ka shkruar Rama në “Facebook”.

shpërshkallëzimin e tensioneve, por edhe për njohjen universale të Kosovës si anëtare e barabartë e bashkësisë ndërkombëtare. “Jemi shumë të shqetësuar për zhvillimet e fundit në marrëdhëniet Kosovë - Serbi. Dëshirojmë t'i inkurajojmë masat për uljen e tensioneve. Në mënyrë të ngjashme, këto dy vende duhet të përqendrohen në normalizimin e marrëdhënieve dhe t'i përmbushin angazhimet e tyre dhe të fillojnë të zbatojnë atë që është rënë dakord këtë vit në

Bruksel dhe Ohër. Ne vazhdojmë ta mbrojmë njohjen universale të Republikës së Kosovës dhe të drejtën e saj për ekzistencë si anëtare e barabartë e bashkësisë së kombeve. Është në interesin tonë ta promovojmë stabilitetin dhe zhvillimin e mëtejshëm të këtij rajoni, si dhe procesin e integritetit evropian, i cili besojmë se mbetet vendimtar për prosperitetin e ardhshëm të fqinjëve tanë dhe që shpresojmë se do të përshpejtohet në vitet e ardhshme”, ka thënë Milanoviqi.



## RAMA IA NXJERRË KARTËN E OKB-SË DELEGACIONIT RUS: SADO QË PËRPIQENI, KOSOVA ËSHTË E PAVARUR

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, gjatë fjalës së tij si drejtues i seancës speciale të thirrur në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për Ukrainën, ka ndarë edhe disa fjalë për pavarësinë e Republikës së Kosovës në këtë panel. “Rusia dhe të tjerë janë përpjekur ta keqpërdorin realitetin e ndryshuar të Ballkanit Perëndimor, sidomos lindjen e Republikës së Kosovës për t'i justifikuar ëndrrat e tyre neo-imperialiste apo makthet e tyre që kanë eksportuar. Pavarësisht sa përpiqeni, Kosova, pavarësia e saj është sanksionuar nga Gjykata Ndërkombëtare Penale, kreu 14 i kësaj karte të OKB-së”, ka thënë Rama, duke shtuar se “Gjykata Ndërkombëtare Penale nuk mund të shërbejë si pretekst për rrëmbim territoresh apo aneksim të paligjshëm”. Sipas tij, nëse paqja që zgjat në rajonin tonë sot është e prekshme, kjo së pari ka të bëjë me mësimet e nxjerra për ta tejkaluar shkuarën dhe për të mësuar një të ardhme të bashku përmes bashkëpunimit. Ndërsa kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka përshëndetur qëndrimin e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Haradinaj ka thënë se këto qëndrime janë jo vetëm të drejta, por konfirmojnë edhe njëherë të drejtën e Kosovës për anëtarësim në institucionet euroatlantike. “Qëndrimet e kryeministrit të Shqipërisë, Edi Rama, në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, jo vetëm që janë të drejta, por konfirmojnë edhe njëherë të drejtën e Kosovës për anëtarësim në OKB dhe në institucionet euroatlantike dhe të drejtën e Ukrainës që ta fitojë luftën kundër agresionit rus. Faleminderit!”, është shprehur Haradinaj.

## Presidenti i Kroacisë në OKB bën thirrje për njohjen universale të Kosovës

**NJU-JORK, 21 SHTATOR** - Kroacia ka bërë thirrje për njohjen universale të shtetit demokratik të Kosovës si anëtar i barabartë i bashkësisë ndërkombëtare para Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB).

Presidenti i Kroacisë, Zoran Milanović, ka bërë thirrje në sesionin e 78 të Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së, që të njihet Kosova. Ai ka shprehur shqetësimin për ngjarjet e fundit në marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si dhe ka bërë thirrje për

INTERVISTË E GABRIEL ESCOBARIT PËR “ZËRIN E AMERIKËS”

# Qeveria Kurti e ka marrë dialogun vetëm me ‘po-jo’, është koha të ndryshojë qasje

I dërguari i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA) për Ballkanin Perëndimor, Gabriel Escobar, e ka kritikuar Qeverinë e Kosovës dhe kryeministrin Albin Kurti për, siç ka thënë ai, se e ka marrë dialogun si një opsion vetëm “po apo jo”. Ai ka thënë se një vend prej 1.5 milionësh nuk mund t’i bindë t’i ndryshojë taktikat e dialogut. “Nuk mendoj se një vend prej një milion e gjysmë do ta bindë komunitetin transatlantik prej 700 milionësh që t’i ndryshojë taktikat e tij. Mendoj se duhet të ketë një përqasje më pragmatike nga Qeveria e Kosovës”, ka thënë ai. Escobari ka shtuar se ShBA-ja e mbështet BE-në si ndërmjetësuese të dialogut. Në këtë kontekst, ai ka thënë se emisari i BE-së për dialogun e ka përkrahjen e BE-së dhe se nuk do të largohet nga kjo pozitë. Ai ka thënë se ka kërkuar nga presidentja Vjosa Osmani dhe kryeministri Kurti t’i dënojnë sulmet ndaj Lajçakut



WASHINGTON, 21 SHTATOR -

**“Zëri i Amerikës”:** Çfarë u kuptua nga takimet e bëra me udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor? A u treguan bindës në angazhimin për të vazhduar në rrugën e integritit euroatlantik që ata kanë zgjedhur?

**Gabriel Escobar:** Kjo varet se me cilët udhëheqës ishte takimi, apo jo? Mund t’ju them tashmë se jam i shqetësuar se po shohim të marrë trajtë një Ballkan i dy shpejtësive. Kemi në njërin anë anëtarët e NATO-s që janë shumë të përkushtuar ndaj orientimit të tyre në NATO dhe atij evropian, pastaj kemi tre të tjerët që po vëzhgohen. Prandaj në takimet e mia unë kam thënë në mënyrë të përsëritur se Shtetet e Bashkuara mbështetin rrugëtimin euroatlantik për të gjithë ata. Dhe do të donim që t’i zgjidhnin dallimet e brendshme dhe rajonale që po i pengojnë të përparojnë.

**“Zëri i Amerikës”:** A mund të na thoni emrat e personave për të cilët po flisni?

**Gabriel Escobar:** Më lejoni t’ia filloj me Maqedoninë e Veriut. E falënderoj Maqedoninë e Veriut për rolin e arsyeshëm udhëheqës dhe rolin udhëheqës evropian, si kryesuese e OSBE-së. Mendoj se ajo që Maqedonia e Veriut provon vazhdimisht është se është një partner shumë i mirë. Dhe në këtë drejtim do të donim të shihnim pjesë të Bashkimit Evropian si një partner shumë i mirë edhe aty. Shqipëria ka qenë e shkëlqyer në përqasjen për vendin që ka në

Këshillin e Sigurimit, si dhe në rrugë dypalëshe dhe në kuadrin e NATO-s. Me Malin e Zi patëm disa takime shumë të mira me presidentin e ri. E siguroam atë se është një partner i mirëpritur dhe i rëndësishëm i komunitetit transatlantik dhe i bëmë thirrje ta inkurajojë krijimin e një qeverie ku marrin pjesë vetëm palë të përqendruara tek Evropa dhe të përkushtuara ndaj NATO-s. Dhe ai tha se do të veprojë kështu. Pra, ne jemi të kënaqur që e mori këtë mesazh të rëndësishëm dhe që ai do të ndërmarrë veprime për këtë.

**“Zëri i Amerikës”:** Dua t’ju pyes edhe për Bosnjën, pastaj do t’ju pyes edhe për Serbinë...

**Gabriel Escobar:** Patjetër. Siç e dini, Bosnja ka disa sfida shumë të mëdha. Mendoj se sfida më e madhe tani është se Dodiku po sfidon bazat e stabilitetit dhe sigurisë të Bosnjë-Hercegovinës për mbi 25 vjet – që është pra Marrëveshja e Paqes e Dejtonit, si dhe të gjitha strukturat brenda saj, përfshirë paqeruajtjen dhe përfaqësuesin e lartë. Pra kjo është realisht sfida më e madhe për Bosnjë-Hercegovinën në këto momente. Kështu që së bashku me zërat e përgjegjshëm duhet të zgjidhim se si ta forcojmë Dejtonit dhe si ta lëvizim përpara Bosnjë-Hercegovinën përgjatë rrugëtimin të saj evropian.

**“Zëri i Amerikës”:** Siç u njoftua të hënën, Serbia nuk iu bashkua zgjatjes së sanksioneve ndaj Rusisë. A patët mundësinë ta diskutoni

këtë çështje me presidentin Vuçiq këtu në Nju-Jork, dhe çfarë i thatë atij?

**Gabriel Escobar:** Nuk e kam takuar presidentin Vuçiq. Do të doja ta them që ne mendojmë se Serbia duhet të vendosë sanksione. Nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të vepruar kështu dhe është qartësisht një vend që mund të drejtojë vetë politikën e tij të jashtme. Por nuk është në të mirë të imazhit të Serbisë që të qëndrojë në periferi të familjes evropiane. Pra kjo është ajo që e kemi thënë vazhdimisht dhe do ta përsëris.

**“Zëri i Amerikës”:** A ka ndonjë arsye të veçantë përse nuk e takuat presidentin Vuçiq? A do ta takoni?

**Gabriel Escobar:** Është thjeshtë çështje e momentit të duhur. Shpresoj ta takoj këtë javë.

**“Zëri i Amerikës”:** Serbia dhe Kosova janë ende në një rënie të gjatë. A ka ardhur koha për një lloj përqasjeje të re nga BE-ja dhe ShBA-ja që do të ndikonte te vendosmëria e tyre?

**Gabriel Escobar:** Jo. Nëse do të më duhej të thosha diçka, nuk do të jetë për një përqasje të re nga partnerët brenda dialogut. Ka ardhur koha për një përqasje të re për disa nga personat që e kanë marrë dialogun si një opsion vetëm “po apo jo”. Dhe e kam fjalën konkretisht për Qeverinë e Kosovës. Ata kanë një detyrim të qartë për çfarë duhet të bëjnë. Dhe mendoj se deklarata e Borrellit ishte shumë e qartë.

Serbinë e inkurajojmë të vazhdojë të jetë konstruktive dhe e duruar, por gjithashtu vazhdojmë t’i kërkojmë Serbisë të mos bëjë ndonjë gjë destabilizuese brenda Kosovës. Do të duhet të vazhdojmë të punojmë me dialogun. Nuk ka alternativë. Nuk ka alternativë për rajonin përveç integritit evropian.

**“Zëri i Amerikës”:** Cili është komenti juaj për kritikën e shprehura nga kryeministri Kurti për ndërmjetësin Miroslav Lajçak?

**Gabriel Escobar:** Lajçaku gëzon besimin e plotë të Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara. Të gjitha vendet e BE-së bënë një deklaratë të përbashkët pas dështimit të bisedimeve, me mbështetje për Lajçakun. Është diçka me të cilën duhet të përballen. Lajçaku nuk do të largohet. Dialogu nuk do të largohet. Dhe nuk mendoj se një vend prej një milion e gjysmë do ta bindë komunitetin transatlantik prej 700 milionësh që t’i ndryshojë taktikat e tij. Mendoj se duhet të ketë një përqasje më pragmatike nga qeveria e Kosovës. Më duhet të them edhe diçka tjetër. Gjatë javës së fundit jam alarmuar nga sulmet personale ndaj Lajçakut që ekzistojnë në sferën shoqërore të Kosovës. I kërkoja presidentes Osmani dhe kryeministrit Kurti që t’i dënojnë këto sulme. Nuk po them se vijnë nga Qeveria e Kosovës, por Qeveria e Kosovës duhet të jetë shumë e qartë se sulmet personale ndaj

përfaqësuesit të posaçëm janë të papranueshme.

**“Zëri i Amerikës”:** Edhe diçka në lidhje me Malin e Zi, që nuk ka ende qeveri. Ju thatë se patët mundësinë t’i diskutoni disa çështje me presidentin Milatoviç. Për çfarë biseduat me të dhe a përcollët rekomandimin amerikan për të mos përfshirë në qeveri ish-Frontin Demokratik, të cilin e konsideroni antipërdimor?

**Gabriel Escobar:** Nuk e kam takuar ende presidentin Milatoviç. Do të takohem me të. Por ai pati takime shumë të rëndësishme, shumë frutdhënëse dhe shumë pozitive me këshilltarin Chollet, me sekretarin e Shtetit, dhe me përfaqësues të Shtetpësisë së Bardhë. Në të gjitha këto takime, Shtetet e Bashkuara ishin shumë të qarta se duam të shikojmë vetëm palë që janë të përqendruara tek integrimi evropian dhe të përkushtuara ndaj NATO-s dhe që ndajnë gjithashtu pozicionin tonë për sa i përket çështjes së Rusisë. Mendoj se jemi shumë të qartë për këtë dhe ai sinjalizoi se është dakord për këtë. Pra duam që të shohim formimin e qeverisë, por duam ta inkurajojmë atë (presidentin Milatoviç) t’i bashkojë palët. Ai ka një rol shumë të rëndësishëm si kreu i shtetit, që t’i japë popullit mesazhin e duhur. Pra jemi të sigurt që e kuptoi atë që donim të thoshim.

## Haradinaj: Ushtria e Kosovës ka kapacitete që bashkë me NATO-n ta bëjë dhe ta ruajë paqen kudo në botë

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka thënë se paqja dhe garantimi i saj, janë sukses i përbashkët i popullit të Kosovës dhe shteteve demokratike të botës.

Kështu ka thënë Haradinaj me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Paqes. “Në Ditën Ndërkombëtare të Paqes, mirënjohje për NATO-n. Për më shumë se 24 vjet Kosova jeton në paqe. Arritja e paqes dhe garantimi i saj është sukses i

përbashkët i popullit të Kosovës dhe shteteve demokratike të botës”, ka thënë Haradinaj. Ai ka shtuar se Kosova dëshiron të jetë pjesë aktive për bërjen dhe mbajtjen e paqes kudo në botë bashkë me NATO-n. “Ne duam të jemi pjesë aktive,

bashkë me NATO-n, për bërjen dhe mbajtjen e paqes kudo nëpër botë. Ushtria jonë ka kapacitete profesionale. Populli ynë me krenari mbështet mundësinë që ushtarët e Kosovës ta ndihmojnë paqen në botë”, është shprehur Haradinaj.



# Gati katër muaj pas sulmeve kundër KFOR-it në veri: Ku arritën hetimet?

**PRISHTINË, 21 SHTATOR** - Gati katër muaj pas dhunës në veri të Kosovës, KFOR-i thotë se pret që Prishtina dhe Beogradi t'i nxjerrin para drejtësisë të gjithë autorët e sulmeve ndaj ushtarëve të tij. Më shumë se 90 pjesëtarë të misionit të NATO-s në Kosovë u plagosën në fund të majit, kur protestat e popullatës lokale serbe kundër kryetarëve shqiptarë të komunave u shndërruan në përlëshje të dhunshme.

Në Kosovë deri më tani janë arrestuar dhjetë persona për "pjesëmarrje në protesta të dhunshme" dhe sulme ndaj pjesëtarëve të KFOR-it. Komandanti i KFOR-it, Angelo Ristuccia, ka thënë më 19 shtator nuk ka informacione të reja rreth hetimeve, por se e di se autoritetet e Kosovës janë duke punuar në to. Ai ka thënë se shpreson që edhe autoritetet në Beograd t'i hetojnë ata persona që "u kthyen në Serbi" pas trazirave. Ristuccia ka thënë se edhe KFOR-i pret që të gjithë autorët e dhunës "të ndiqen penalisht menjëherë".

## Çfarë thonë në Beograd?

Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë nuk u është përgjigjur pyetjeve të "Radios Evropa e Lirë" se a po punohet në këtë rast dhe a do të arrestohen autorët e dhunës që gjenden në Serbi. "REL"-i ka pyetur edhe të ashtuquajturën Zyrtë për Kosovën në Qeverinë e Serbisë në lidhje me pretendimet se ata që kanë marrë pjesë në protesta të dhunshme në veri të Kosovës, gjenden në Serbi, por nuk ka marrë përgjigje. Tensionet në veri të Kosovës - zonë e banuar me shumicë serbe - filluan më 26 maj, kur grupe të serbëve lokalë u mblodhën para ndërtesave komunale për ta kundërshtuar hyrjen e kryetarëve të rinj shqiptarë në këto ndërtesa. Situata u përshkallëzua më 29 maj, kur demonstruesit në komunën e Zveçanit u përlëshën me pjesëtarë të KFOR-it.

Nëntëdhjetë e tre ushtarë të KFOR-it ishin plagosur rëndë dhe lehtë, ashtu si edhe disa protestues. "Dihet saktësisht se kush ishte atje, çfarë është dhe nga vjen. Dihet, gjithashtu, se ata nuk kanë mundur të veprojnë pa koordinim me Listën Serbe dhe me Serbinë", ka thënë për "Radion Evropa e Lirë", Dushan Janjiq, nga Forumi joqeveritar për Marrëdhënie Etnike, me seli në Beograd. Lista Serbe, partia më e madhe e serbëve të Kosovës, e cila ka mbështetur autoritetet në Beograd, i kishte dënuar sulmet

ndaj KFOR-it, por edhe arrestimet e serbëve që lidhen me këto sulme. Pas dhunës në Zveçan më 29 maj, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, u kishte bërë thirrje demonstruesve që "të mos hyjnë në konflikt me NATO-n" dhe të protestojnë në mënyrë paqësore. Ai e kishte fajësuar kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, për trazirat, duke thënë se Kurtit "i konvenon të ketë konflikt mes NATO-s dhe serbëve".

Qeveria e Kosovës, në anën tjetër, ka këmbëngulur se pas trazirave të fundit në veri të Kosovës qëndron Beogradi zyrtar dhe "grupet kriminale të afërta me Vuçiqin".

## Çfarë thonë në Prishtinë?

Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria e Kosovës nuk u është përgjigjur pyetjeve të "REL"-it për ecurinë e hetimeve të sulmit ndaj ushtarëve të NATO-s, sa persona janë duke u hetuar dhe nëse të gjithë ata janë në dispozicion të autoriteteve gjyqësore. Nga dhjetë personat që janë arrestuar në lidhje me trazirat, disa u liruan për t'u mbrojtur në liri, ndërsa dy pjesëtarë të komunitetit serb u dëbuan nga Kosova.

Më 2 qershor, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u kishte thënë deputetëve në Kuvendin e Kosovës se institucionet kanë identifikuar 45 persona, që kanë lidhje me trazirat dhe me sulmet ndaj KFOR-it, dhe i lexoi publikisht emrat e tyre. Ai, po ashtu, kishte thënë se në mesin e të tubuarve në protestën në Zveçan më 29 maj, kishte edhe tifozë të klubit beogradas të futbollit "Cervena Zvezda". Ehat Miftaraj, drejtor i Institutit të Kosovës për Drejtësi, i cili monitoron punën e policisë, prokurorisë dhe gjykatave, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se janë iniciuar disa raste në lidhje me sulmet ndaj KFOR-it. "Rastet e tilla janë duke u hetuar dhe disa persona të arrestuar janë duke u hetuar përmes procedurave të rregullta gjyqësore", ka thënë ai.

## Kush janë personat që i sulmuan ushtarët e NATO-s?

Si pjesëmarrës kryesorë në sulmet kundër KFOR-it, autoritetet e Kosovës i emëruan pjesëtarët e organizatave "Mbrotjtja Civile" dhe "Brigada e Veriut" - që të dyja të shpallura terroriste nga Prishtina zyrtare. Si lider i "demonstruesve të dhunshëm" dhe organizator i sulmeve ndaj KFOR-it u identifikua



Millun Millenkoviç - Llune, i cili është arrestuar më 13 qershor dhe është ende në paraburgim. Ai akuzohet për tri vepra: terrorizëm, ndryshim të dhunshëm të rendit kushtetues të Kosovës dhe rrezikim të personelit me mbrojtje ndërkombëtare.

Ministri i Brendshëm i Kosovës, Xhelal Sveçla, kishte thënë se Millenkoviç "është një nga liderët e formacionit kriminal 'Mbrotjtja Civile' dhe lider i grupeve kriminale që me vite i terrorizojnë qytetarët, i sulmojnë pjesëtarët e Policisë së Kosovës dhe institucionet e Republikës së Kosovës". Në Mitrovicën e Veriut ishin mbajtur protesta pas arrestimit të Millenkoviçit. Lista Serbe ka kërkuar amnisti për të gjithë serbët e arrestuar që kanë marrë pjesë në protesta kundër vendimeve të Qeverisë së Kosovës.

Në fund të qershorit, kryeministri i Kosovës kishte kërkuar nga Serbia që t'i tërheqë "demonstruesit e saj të dhunshëm para ndërtesave komunale dhe vendeve përreth", si dhe të bashkëpunojë në ndjekjen penale të atyre që i kanë shkelur ligjet e Kosovës. Kosova dhe Serbia nuk bashkëpunojnë drejtpërdrejt në hetime.

Misioni i BE-së për Sundimin e Ligjit në Kosovë, EULEX, i ka thënë "REL"-it se çështja e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Serbisë lidhur me hetimet e sulmeve ndaj ushtarëve të KFOR-it, është "jashtë mandatit të EULEX-it".

Në përshkrimin e mandatit të këtij misioni, që gjendet në ueb-faqen e tij është thënë ndër të tjera se "EULEX-i mbështet Policinë e Kosovës në fushën e bashkëpunimit policor ndërkombëtar, duke lehtësuar shkëmbimin e informacioneve ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Interpol-it, Europol-it, ose Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë".

Miftaraj, nga Instituti i Kosovës për

Drejtësi, beson se Serbia është një "parajsë për individët që kryejnë vepra kriminale në Kosovë", sepse Beogradi refuzon të bashkëpunojë rreth ekstradimit apo ndjekjes së tyre penale. "Një qasje e tillë paraqet edhe shkelje të standardeve të sundimit të ligjit. Vërtet duhet të ketë më shumë presion nga BE-ja", ka thënë Miftaraj.

Edhe Janjiq, nga Forumi i Beogradit për Marrëdhënie Etnike, ka thënë se Serbia duhet të japë informacione dhe t'i dorëzojë përgjegjësit për sulme ndaj ushtarëve të NATO-s. "Nëse keni nevojë që KFOR-i t'ju bindë publikisht për këtë, atëherë keni një problem të madh në vend dhe pasojë edhe më të mëdha politike nga mosveprimi juaj", ka thënë Janjiq.

Janjiq ka theksuar se Serbia i është shmangur "reagimit të ashpër" të KFOR-it, për faktin se asnjë ushtar i NATO-s nuk ka vdekur, përkundër lëndimeve të rënda. "Kjo është një krizë shumë serioze e mosbesimit në Beograd. Natyrisht, nuk ka një vetëdije më të madhe se ne jemi në një lojë të rrezikshme, e cila quhet krizë sigurie", ka thënë ai.

Ky nuk është rasti i parë dhe i vetëm ku pjesëmarrësit në trazira apo të akuzuarit për krime në Kosovë, strehohen në Serbi, ku edhe jetojnë të lirë.

Nënkryetari i Listës Serbe në Kosovë, Millan Radoičiq, prej vitesh ndodhet në Serbi, ku edhe merr pjesë në takime me zyrtarë të lartë, edhe pse Prishtina zyrtare e akuzon për përfshirje në rastin "Brezovica", që ka të bëjë me ndërtime pa leje. Më herët, për Radoičiqin ishte lëshuar një urdhërarrestim nën dyshimin se ishte i lidhur me vrasjen e politikanit opozitar serb në Kosovë, Oliver Ivanoviç. Megjithatë, ky urdhërarrestim u tërhoq pa ndonjë shpjegim në mars të vitit 2021. Radoičiqi ishte ende në Serbi atëkohë. Radoičiqi gjendet edhe në listën e zezë të Shteteve të

Bashkuara, së bashku me biznesmenin nga veriu i Kosovës, Zvonko Veselinoviç, dhe me dhjetë serbë të tjerë, nën dyshimet se u përkasin rrjeteve korruptive të lidhura me krimin e organizuar ndërkombëtar.

## Instituti i Kosovës për Drejtësi u bënë thirrje politikanëve të mos i komentojnë hetimet

Miftaraj ka thënë se Instituti i Kosovës për Drejtësi vazhdimisht kërkon nga politikanët që të mos i komentojnë publikisht rastet në zhvillim, të cilat janë objekt i hetimeve penale ose i procedurave gjyqësore. "Një sjellje e tillë mund të kuptohet si ndikim në pavarësinë e punës së gjyqësorit, por edhe të ndikojë në paanshmërinë dhe konfidencialitetin e hetimeve", ka thënë ai.

Kjo, ka thënë Miftaraj, i referohet kryeministrit Kurti, i cili publikisht i kishte lexuar emrat e personave për përfshirje të dyshuar në sulme, por edhe Listës Serbe, e cila i dënon vazhdimisht arrestimet. "Politikanët në Kosovë duhet të dërgojnë mesazhe që promovojnë një mjedis paqësor dhe kontribuojnë në bashkëjetesë, e jo e kundërta", ka thënë Miftaraj.

KFOR-i vazhdon t'i ruajë ndërtesat e tri komunave në veri të Kosovës. Më 27 qershor, përfaqësuesi i posaçëm i Bashkimit Evropian në dialogun Kosovë-Serbi, Mirosllav Lajçak, ka prezantuar një plan për uljen e tensioneve atje. Plani përfshin tërheqjen e njësisve speciale të policisë së Kosovës nga ndërtesat komunale në veri, zhvendosjen e kryetarëve të komunave nga këto objekte në ndërtesa alternative, shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme dhe fillimin e procedurave gjyqësore kundër demonstruesve që sulmuan trupat e KFOR-it. Nga Serbia pritet të mundësojë pjesëmarrjen e serbëve në zgjedhje dhe të sigurojë se ata nuk do të frikësohen për shkak të zgjedhjeve të tyre personale për të votuar, si dhe t'u ofrojë mbështetje autoriteteve përgjegjëse në procedurat kundër sulmuesve, gjatë protestave në veri. Trazirat dhe dhuna në veri penguan dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit për normalizimin e marrëdhënieve, i cili zhvillohet që nga viti 2011 me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian. Pa përparim ka përfunduar edhe takimi i kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, me presidentin e Serbisë, Aleksandër Vuçiq, më 14 shtator në Bruksel.

## Zëdhënësi i BE-së: Themelimi i Asociacionit duhet të nisë pa vonesë

Bruksel, 21 shtator - Zëdhënësi i Bashkimit Evropian (BE), Peter Stano, ka folur edhe njëherë rreth krijimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. Stano ka thënë se themelimi i këtij asociacioni duhet të nisë menjëherë.

"Kur është fjala për Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe, qëndrimi i BE-së është shumë i qartë. Në vazhdimësi është përsëritur në disa konkluzë të ministrave të jashtëm dhe në fund në deklaratën e 27 shteteve anëtare për

dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë. BE-ja dhe vendet anëtare kërkojnë që themelimi i Asociacionit të nisë pa vonesa shtesë dhe pa parakushte dhe secila palë e di mirë se çfarë duhet të bëjë, sepse nuk është hera e parë që kjo çështje është në

tavolinë", ka thënë Stano, duke shtuar se statuti i këtij asociacioni duhet të diskutohet në dialog. "Çështja se si të bëhet, në çfarë mënyre, si do të duket, si do të operojë, cili do të jetë statuti, duhet të diskutohet në dialog", ka thënë Stano.



## Miletiqi jep dorëheqje nga pozita e këshilltarit të Kurtit

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Petar Miletiqi ka dhënë dorëheqje nga pozita e këshilltarit të kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti. Ai dorëheqjen e ka shpjeguar përmes një letre të cilën ia ka dërguar Kurtit. Në letër është thënë se e ka kuptuar që si këshilltar i jashtëm roli i tij nuk do të ishte i rëndësishëm sa i përket ndihmës së serbëve në Kosovë. "Me këtë letër dua t'ju

njoftoj se nga sot nuk jam formalisht këshilltar i jashtëm politik i Kryeministrit të Kosovës. Në fjalitë e ardhshme, kam ndërmend të shpjegoj vendimin tim. E kuptova në fillim të këtij viti se roli im si këshilltar i jashtëm nuk do të ishte i rëndësishëm dhe më vonë nuk do të ishte funksional sa i përket ndihmës së serbëve në Kosovë", është thënë në letërën

e Miletiqit. Më tutje, ai ka thënë se nuk është pyetur dhe as konsultuar për asnjë vendim të kryeministrit apo të qeverisë. Ai është ankuar edhe për ndarjen e fondeve për organizatat joqeveritare duke thënë se ato janë ndarë vetëm për OJQ-të shqiptare. Miletiqi ka thënë se dorëheqja e tij nuk është për shkak të presioneve.



## BE-ja thotë se është në kontakt me Kosovën për tre serbët e arrestuar për krime lufte

Bruksel, 21 shtator - Bashkimi Evropian (BE) nuk i vë në dyshim autoritetet e Kosovës për hetimin e krimeve të luftës dhe është në kontakt me to, për të pasur një pasqyrë të plotë rreth arrestimit të disa serbëve në veri të Kosovës, ka thënë të enjten zëdhënësi i BE-së, Peter Stano.

Prokuroria Speciale e Kosovës ka njoftuar të mërkurën se ka arrestuar tre persona të komunitetit serb nën dyshimet për kryerje të "krimeve të luftës kundër popullsisë civile".

I pyetur nëse po e vinte në pikëpyetje autoritetin e Kosovës për t'i hetuar rastet e krimeve të luftës dhe për të ngritur aktakuza në një konferencë për media në Bruksel, Stano ka thënë: "Kur fola për atë se çfarë po ndodh në veri të Kosovës lidhur me arrestimet nga ana e policisë, nuk thashë se



po vëmë në pikëpyetje ndonjë gjë". "Thashë se jemi në kontakte të ngushta me partnerët tanë dhe me autoritetet relevante për të kuptuar se çfarë po ndodh dhe si po kryhen këto veprime. Thashë

se po i mbledhim informatat e nevojshme në përgjithësi", ka thënë Stano.

Stano ka theksuar se BE-ja është duke mbledhur informacione rreth këtij rasti dhe se "nëse do të

ketë nevojë, BE-ja do të reagojë edhe publikisht", dhe se "qëndrimi i BE-së për procedimin e krimeve të luftës nuk ka ndryshuar".

Prokuroria Speciale e Kosovës ka

njoftuar se tre të arrestuarve u është caktuar masa e ndalimit deri në 48 orë, pa dhënë ndonjë hollësi se për çfarë krime lufte akuzohen ata.

Prej përfundimit të luftës së fundit në Kosovë, rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 prej Misionit të Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX).

Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore. Në luftën e zhvilluar në Kosovë më 1998/99, janë vrarë mbi 13 mijë civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur.

## Bislimi: Kosova dhe Zvicra ndajnë miqësi dhe partneritet të ngushtë



PRISHTINË, 21 SHTATOR - Zëvendëskryeministri i parë i Kosovës, Besnik Bislimi, ka pritur në takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës në Prishtinë, Thomas Kolly. Sipas njoftimit të qeverisë, në këtë takim është biseduar për forcimin e bashkëpunimit mes të dyja vendeve, njëherësh për potencialin për zhvillim të Kosovës dhe për mundësitë që ofrohen për investim. "Zëvendëskryeministri i parë për Integrim Evropian, Zhvillim dhe Dialog i Republikës

së Kosovës, Besnik Bislimi, priti në një takim lamtumirës ambasadorin e Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly. Kosova dhe Zvicra ndajnë një miqësi e partneritet të ngushtë mes tyre. Në këtë takim u bisedua mbi forcimin e bashkëpunimit, potencialin për zhvillim të Kosovës dhe mundësitë që vendi ynë ofron për investim. Ambasadori Kolly nga ana e tij veçoi sektorin e TI dhe suksesin e Kosovës në këtë drejtim. Bisedat miqësore mes zëvendëskryeministrit Bislimi dhe

ambasadorit Kolly kanë qenë të shpeshta e të frytshme. Edhe në këtë takim lamtumirës ata e vlerësuan njëri-tjetrin për gatishmërinë për bashkëpunim dhe kontributin e vazhdueshëm për forcimin e marrëdhënieve mes shteteve tona", ka njoftuar qeveria. Sipas këtij njoftimi, Bislimi e ka falënderuar ambasadorin për kontributin e tij, teksa ka ritheksuar që Zvicra mbetet partnere e rëndësishme me të cilën ndan vlera të përbashkëta me Kosovën.

## Trafiku Urban edhe në 'Google Maps'

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kryetari i Prishtinës, Përparim Rama, ka njoftuar të enjten për një ndryshim pozitiv në transportin publik. Ai ka bërë me dije se në aplikacionin "Google Maps" tashmë është inkuadruar mundësia që si mjet udhëtimi të përdoret transporti publik për të shkuar në destinacionin e kërkuar. "Një tjetër ndryshim pozitiv në transportin publik. Jam i lumtur të ndaj me ju një arritje të re e cila do të

përmirësojë përvojën tuaj me transportin publik. Kemi inkuadruar në 'Google Maps', mundësinë që si mjet udhëtimi të përdorni transportin publik për të shkuar në destinacionin e kërkuar", ka shkruar Rama në "Facebook". Pra, në "Google Maps" janë përfshirë linjat e autobusëve të Trafikut Urban në Prishtinë. Kjo, sipas Ramës, do t'i ndihmojnë udhëtarët t'i gjejnë oraret dhe ndaljet e

fundit të transportit publik në kryeqytet. "Mësoni se cila linjë e autobusit është më afër ardhjes dhe më e shpejtë për destinacionin që do të shkoni. Kuptoni se sa minuta bëni për të shkuar në këmbë, sa me transport publik deri në destinacionin tuaj. Bashkohuni në rrugëtimin tonë drejt një transporti publik më efikas, më të qëndrueshëm dhe më të lehtë për të gjithë qytetarët!", ka shkruar Rama.



# Mbrojtja e Shalës: ZPS-ja po peshkon për informacion për çështjen e liderëve të UÇK-së

HAGË, 21 SHTATOR - Avokati Jean-Louis Gilissen në seancën e së enjtes, në gjykimin ndaj Pjetër Shalës, ka thënë se Zyra e Prokurorit të Specializuar (ZPS) është duke peshkuar për informacion për çështjen ndaj Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit. Këtë avokati Gilissen e ka thënë gjatë kohës sa prokurori i specializuar Filippo De Minicis i ka bërë kundërpjetje dëshmitarit Bardhyl Mahmuti.

Ai ka thënë se pajtohet me ZPS-në për të kuptuar pozitën e dëshmitarit, por pjesa tjetër është që të peshkohet për informacione apo të nxjerrin informacione për çështjen Thaçi dhe të tjerët.

Gilissen ka thënë se është vendosur që të bëhet lidhja mes asaj që dëgohet dhe çështjes së Pjetër Shalës dhe se ajo çfarë po bëhet në këtë seancë nuk ka fare lidhje, sipas tij, me çështjen e Shalës.

Ai sërish ka këmbëngulur në shprehjen "po peshkojnë informacion" duke shtuar se ishte afër që të largohet nga salla dhe se është mbushur kupa. "Mjaft! U mbush kupa! Jemi profesionistë këtu. Nuk jemi kriminelë", ka reaguari avokati Gilissen.

Edhe avokati tjetër, Mohamed Hedi Aouini, ka thënë se nga kundërpjetjet e prokurorit nuk po jepet dëshmi për çështjen e Shalës, por se janë duke u bërë politika si ushtrim për ta minuar kredibilitetin e dëshmitarit dhe për të nxjerrë dëshmi për çështjen Thaçi dhe të tjerët. Sipas tij, prokuroria po tenton ta nxjerrë politikën, strukturën dhe se kjo shkon përtej asaj që ka ndodhur në Kukës, duke kërkuar nga trupi gjyqësor të mbrohet integriteti i këtij procesi gjyqësor. Këto reagime të avokatëve mbrojtës të Shalës kanë ardhur pas prezantimit të një komunikate nga prokurori De



Minicis, ku është thënë se shtabi i përgjithshëm i ka publikuar emrat e gjashtë përfaqësuesve politikë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK-së).

Ndaj pyetjeve të prokurorit lidhur me këtë çështje, Bardhyl Mahmuti ka thënë se nuk mund të japë një përgjigje me "po ose jo". Mahmuti ka treguar se ai ka qenë

vetëm përfaqësues politik i UÇK-së dhe jo zëdhënës, duke shtuar se ka qenë vetëm një zëdhënës i UÇK-së dhe ai ishte Jakup Krasniqi.

Ndërsa kur është pyetur nëse me komunitetin ndërkombëtar kishte biseduar lidhur me kapjen dhe lirin e të burgosurve të luftës nga UÇK-ja, mbrojtja ka reaguari

duke thënë se këto nuk kanë lidhje me fajësinë apo pafajësinë e Shalës dhe se kjo ka të bëjë me çështjen Thaçi dhe të tjerët.

Por me lejin e pyetjes nga trupi gjyqësor, dëshmitari ka thënë se i kujtohet të ketë folur për zënien rob të 6-7 ushtarëve në Shalë të Bajgorës dhe se ishte kontaktuar për këtë nga diplomatë amerikanë. Po ashtu, ai ka thënë se nuk ka diskutuar me diplomatë të shteteve perëndimore për ndalimin apo arrestimin e civilëve nga UÇK-ja. Sipas tij, "për shkak të propagandës serbe janë shtruar edhe pyetje të kësaj natyre, por përgjigje ka qenë kategorike se nuk ka të burgosur nga ana e UÇK-së".

Ai ka thënë se mbështet qëndrimin se çdo gjë e dorëzuar nga komisionet e shërbimeve sekrete serbe në krye me gazetarin Mirollav Drejqev, sipas tij, janë sajesa që kanë qëllim ta diskreditojnë luftën e UÇK-së. /Betimpërdrejtësi/

## Me akuza dhe kundërakuza themelohet Komisioni Hetimor për Rezervat Shtetërore

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kuvendi i Republikës së Kosovës të enjten ka themeluar Komisionin Hetimor për Rezervat Shtetërore. Në favor të këtij komisioni kanë votuar 69 deputetë. Ky komision do të drejtohet nga deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, ndërsa zëvendëse e tij është caktuar deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku. Në këtë komision Lëvizja Vetëvendosje do të përfaqësohet nga deputetët Armend Muja, Halil Thaçi, Shqipe Metaj-Isufi, Driton Hyseni dhe Salih Zyba. Ndërsa nga opozita anëtarë të këtij komisioni do të jenë Ferat Shala nga PDK-ja, Doarsa Kica-Xhelili nga LDK-ja dhe Pal Lekaj nga AAK-ja.

Para se të votohet ky komision është zhvilluar një debat i ashpër në mes të pozitës dhe opozitës.

Ndonëse partitë opozitare kanë mbledhur mbi 40 nënshkrime për themelimin e këtij komisioni, partia në pushtet ka kritikuar iniciativën e LDK-së, e cila është mbështetur nga PDK-ja dhe AAK-ja.

Fillimisht, shefi i grupit parlamentar i LDK-së, Arben Gashi, ka bërë me dije se themelimi i një komisioni të tillë është i domosdoshëm. "I paraqesim Kuvendit të Kosovës propozimin për formimin e komisionit hetimor parlamentar lidhur me procedurat për furnizimin dhe menaxhimin e rezervave shtetërore dhe hetimin parlamentar lidhur me keqpërdorimin e mundshëm të rezervave shtetërore nëpërmjet kualifikimit të procedurës si sekrete shtetërore për furnizime



të tilla", ka thënë Gashi.

Ai ka vlerësuar se është shumë e nevojshme të dihet se çfarë ka ndodhur me procedurën e blerjes së produkteve në emër të rezervave shtetërore. "Duke pasur parasysh indicet për dyshimet të bazuara për abuzime të mundshme e konsiderojmë të nevojshme të bëhet hetim i thelluar parlamentar. Me qëllim të ushtrimit të mandatit tonë kushtetues parlamentar, theksojmë nevojën e madhe të zhvillimit të këtij hetimi, veçanërisht kur kihet parasysh fakti që rezerva shtetërore është e nivelit kryesor të sigurisë nacionale. Mënyra e menaxhimit nga qeveria dhe institucioneve të tjera të sigurisë është me rendësi jetike", ka thënë Gashi.

Insistimi i opozitës për të themeluar një komision të tillë është kundërshtuar nga Lëvizja Vetëvendosje. Shefja e grupit parlamentar e Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, i ka akuzuar deputetët e opozitës se po duan të bëhen

hetues dhe se nuk po i besojnë prokurorisë. "Më 5 shtator grupi parlamentar i LDK-së ka ndërmarrë një hap, që është hap i ngutshëm sipas LV-së, duke dorëzuar në Kuvend kërkesën për themelimin e Komisionit Hetimor për hetimin e procedurave të rezervave shtetërore. Disa muaj më herët në foltore e në medie janë përmendur dyshimet se mund të ketë keqpërdorime të rezervave, për të cilat ka reaguari prokuroria. Në gusht në mënyrë spektakulare ka arrestuar dy persona në MINT", ka deklaruar ajo.

Kusari-Lila ka vlerësuar se me këtë komision opozita është duke dashur të krijojë skena dhe "show mediatic". "Kjo kërkesë nuk ka kuptim. Opozita ka dalë në mbrojtje të prokurorisë. Aktualisht po tregon mosbesim ndaj punës së saj. Mendojnë që përfaqësuesit e Kuvendit mund të jenë hetues më të mirë sesa organet e rendit. Më duhet t'i kthehem përvojës nga Komisioni Parlamentar për Menaxhimin e

Pandemisë ku ka pasur dëshmitarë që nuk janë përgjigjur. Prandaj, do të përfundojmë me komision hetimor që synon të krijojë skena interesante, të krijojë show mediatic, ta shpenzojë paranë publike, t'i kthejë deputetët në hetues, përderisa hetuesit janë duke u marrë me çështje", është shprehur ajo.

Ndaj qëndrimit të Kusari-Lilës ka reaguari shefi i deputetëve të PDK-së, Abelard Tahiri. Ai ka thënë se me këtë komision deputetët e opozitës nuk dëshirojnë të bëhen hetues, por ta zbulojnë të vërtetën për skandalin e rezervave shtetërore. Tahiri ka thënë se komisioni do ta hetojë edhe mbledhjen online të qeverisë Kurti, në të cilën është vendosur për rezervat shtetërore. "Ne nuk po kërkojmë të bëhemi hetues. Ne po kërkojmë ta përfundojmë mandatin tonë si deputetë. Kam hyrë e kam bërë një hulumtim dhe e shihni mbledhjen e qeverisë. E keni vetëm një vendim. Siç duket, ka qenë vetëm mbledhje online. Ka shumë çështje politike që kanë dërguar deri të marrja e këtij vendimi. Nga të dhënat në Komisionin Hetimor për energjinë patëm edhe arrestime. Ato procesverbale të Komisionit Hetimor i kanë shërbyer prokurorisë", ka thënë Tahiri. Më tutje, shefi i grupit parlamentar i AAK-së ka thënë se duhet të hetohet se cila ka qenë lidhja e të dyshuarit Ridvan Muharremi me ministrin e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), Rozeta Hajdari. "Mimoza Kusari duhet ta dijë që pushtetet janë të ndara dhe kur një shefe e grupit parlamentar

thotë se prokuroria ka bërë spektakël, këtu është ndërhyrja. Këtu menjëherë ndërhyjnë politika. Personi në fjalë, zotëri Ridvan Muharremi, çka do të thotë për ministrin? Ne duhet të dimë se cili është roli i tij në rezerva shtetërore. A është faji te Rozeta a te Ridvani? Tani ku mbet ai polaku? Qysh hyri ai polaku në këtë proces të rezervave shtetërore? Jemi duke folur për një marrëveshje sekrete - konfidenciale", ka theksuar Tahiri.

Në këtë debat është përfshirë edhe deputeti i pavarur, Haki Abazi, i cili më herët ka qenë pjesë e Vetëvendosjes. Abazi ka hedhur akuza të ashpra në drejtim të disa deputetëve të Vetëvendosjes. Ai ka thënë se Mimoza Kusari-Lila dhe Armend Muja janë deputetët më të korruptuar të partisë në pushtet. "Armend Muja është njeriu më i korruptuar në grupin parlamentar. Është me vepër penale për korrupsion të akreditimit të universiteteve. Nuk ndërtohet standardi me njerëz të korruptuar si Mimoza Kusari e Armend Muja. Kanë qenë ndërtuesit e korrupsionit e kriminalitetit brenda institucionit për 20 vjet", ka thënë Abazi. Komisioni Hetimor parlamentar do t'i hetojë dyshimet për dallavere të rezervave shtetërore, saktësisht për vaj, grurë dhe sheqer. Për këtë çështje, "Nacionale" kishte publikuar disa përgjime, në të cilat dëshmohej se mijëra euro ishin paguar për mallra të rezervës shtetërore, por produktet nuk kanë ardhur ende. Për këto dyshime janë arrestuar zyrtarë të MINT-it dhe afaristë Ridvan Muharremi, të cilët janë liruar nga paraburgimi.

## Kuvendi dështon ta ratifikojë marrëveshjen ndërkombëtare për rehabilitimin e linjës hekurudhore

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kuvendi i Kosovës, për shkak të mungesës së kuorumit, nuk ka arritur ta ratifikojë marrëveshjen për rehabilitimin e linjës hekurudhore. Ani pse në seancë ishin 82 deputetë, në

votim kanë marrë pjesë vetëm 72. Deputetët e PDK-së nuk ka marrë pjesë në votim, ndërsa ata të AAK-së nuk ishin në sallë. LDK-ja është e vetmja parti opozitare që e ka përkrahur marrëveshjen ndërkombëtare

në mes të Republikës së Kosovës, përfaqësuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve dhe Bankës Evropiane për Investime për projektin "Rehabilitimi i linjës hekurudhore 10 B".



## Prodhimi i Brendshëm Bruto i Kosovës arrin rreth 9 miliardë euro

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2022 ka arritur në 8.94 miliardë euro, ku për kokë banori është 5 037 euro. Kështu është thënë në raportin "Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) me qasjen e shpenzimeve dhe të prodhimit, 2008-2022", i cili është prezantuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK). Sipas ASK-së, rritja reale e PBB-së për këtë vit, krahasuar me vitin 2020, ishte 5.2 për qind. "PBB-ja me çmime aktuale në vitin 2022 ishte 8.94 miliardë euro, derisa rritja reale në vitin 2022 ishte 5.2 për qind krahasuar me vitin



2021. PBB për kokë banori për vitin 2022 ishte 5,037 euro", ka njoftuar ASK-ja. Në këtë raport është theksuar se tregtia ishte sektori me rritjen reale më

të madhe ekonomike. "Tregtia me shumicë dhe pakicë me 10.8 për qind, informim dhe komunikim 9.2 për qind, aktivitete profesionale, shkencore dhe

teknike 7 për qind, aktivitete administrative dhe mbështetëse 6.7 për qind, aktivitete financiare dhe të sigurimit 6.4 për qind, industria përpunuese 5.6 për qind, transporti dhe magazinimi 5.4 për qind, art, zbavitje dhe rekreacion 4.7 për qind. Bujqësia, gjuetia, pylltaria dhe peshkimi 4.5 për qind, patundshmëria 4.1 për qind, hotelet dhe restorantet 3.7 për qind, shëndetësia dhe aktivitetet e punës sociale 3.6 për qind, edukimi 3.2 për qind, furnizimi me ujë 3 për qind, industria nxjerrëse 2.9 për qind, shërbimet e tjera 2.6 për qind dhe furnizimi me

energji elektrike e gaz 1.4 për qind", ka njoftuar ASK-ja. Sipas këtij raporti, rënie ka pasur në ndërtimtari 3.1 për qind, administrim publik dhe sigurim të detyrueshëm social 0.5 për qind.

Në anën tjetër, rritje reale sipas komponentëve kryesorë të PBB-së me qasjen e shpenzimeve për vitin 2022 ishte importi i shërbimeve 21.3 për qind, eksporti i shërbimeve 20 për qind, eksporti i mallrave 16.1 për qind, shpenzimet e konsumit final 4 për qind, importi i mallrave 2.2 për qind dhe shpenzimet e konsumit final të qeverisë 0.2 për qind.

## Kosova së shpejti me të dhëna për shkallën e ndotjes së ajrit nga automjetet

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), në bashkëpunim me agjencinë japoneze "JICA", kanë zhvilluar fazën e dytë të projektit për zhvillimin e kapaciteteve për kontrollin e ndotjes së ajrit në Kosovë. Qëllimi është që të krijohet një databazë me të dhëna dhe të ndërmerren masa varësisht nga rezultati që del nga matjet. Zëvendësministri i MMPHI-së, Avni Zogiani, ka thënë se qëllimi i këtij projekti është të hulumtojnë se në çfarë mase të ndotjes së ajrit kontribuon trafiku në përgjithësi. Zogiani ka thënë se pret që ky projekt të ketë sukses. Ai ka treguar se nëse nga të dhënat që sigurohen nga pajisjet matëse del se ka ndotje të madhe, do të propozohet



zëvendësimi i automjeteve me karburante në ato elektrike. "Nëse automjetet janë ndotëse, që mund të supozojmë tash se janë,

duhet të dimë në çfarë mase. Atëherë duhet të bëjmë politika për zëvendësimin e automjeteve me karburante me ato elektrike, me

transport elektrik ose zëvendësim të makinave individuale me transport publik", ka thënë Zogiani. Zogiani ka thënë se makinat

të cilat do të detektohen se po ndikojnë në prishjen e kualitetit të ajrit do t'u nënshtrohen kontrollit teknik dhe, pas ekzaminimeve, do t'u bëhet me dije ngasësve se ku është problemi i automjetit.

Ndërsa udhëheqësi i projektit nga agjencia japoneze "JICA", Kuwahara Fumihiko, ka thënë se kanë në plan të krijojnë databazën e të dhënave për ndotje.

Faza e dytë e këtij projekti nga agjencia japoneze "JICA" ka filluar rreth një vit e gjysmë e parashihet të përfundojë në fund të vitit 2025.

Ndërsa "Projekti për ngritjen e kapaciteteve për menaxhimin e mbeturinave drejt një shoqërie të shëndoshë në Republikën e Kosovës", i takon fazës së parë, që ka zgjatur rreth pesë vjet.

## Lugina e Preshevës së shpejti do të bëhet me plan të fizibilitetit ekonomik

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka pritur të enjten në takim një delegacion të Unionit të Afaristëve -

Vizioni Pmb, i udhëhequr nga kryetari Xhelal Memeti, me rastin e arritjes së një suksesi të madh të këtij unioni në Luginë të Preshevës.

Ky union ka nënshkruar një marrëveshje për të hartuar një plan të fizibilitetit ekonomik dhe demografik për tri komuna: Preshevë, Bujanovc dhe Medvegjë me


qëllim të zhvillimit ekonomik të asaj anë. Ky plan i fizibilitetit do të përfundojë në maj të vitit 2024 nga Instituti i Shkencave të Teknologjisë në Prishtinë.







**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Kosova, dy pozita më poshtë në renditjen e FIFA-s, Shqipëria tri më lart

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll ka rënë edhe dy pozita më poshtë në renditjen e FIFA-s pas dy ndeshjeve që "dardanët" i zhvilluan në këtë muaj, fillimisht barazuan me

Zvicrën (2-2), më pas u mposhtën nga Rumania (2-0). Nga pozita 109 që renditej në korrik, Kosova tani zë vendin e 111-të. Në anën tjetër, Shqipëria ka marrë rezultate pozitive duke u ngritur për tri pozita nga

renditja e fundit. Nga pozita e 65-të, tani "kuqezinjët" gjenden në vendin e 62-të. Nën urdhrat e Sylvinhos, Shqipëria është duke "fluturuar", meqenëse mposhti Poloninë dhe barazoi me Republikën Çeke

në muajin shtator. Me një fitore në "Air Albania" në tetor, Shqipëria mund të thuhet se e ka siguruar pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian "Euro 2024" që mbahet në Gjermani.



## Ejupi largohet pas 20 vjetësh nga FC Prishtina, Haradini zgjedhet president i ri

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Ndryshime të mëdha janë bërë të enjten në klubin më të madh në vend, FC Prishtina. Pas mbledhjes së jashtëzakonshme është bërë me dije se presidenti Remzi Ejupi është larguar përfundimisht nga klubi kryeqytetas pas 20 vjetësh, duke ia shitur aksionet Rrahman Haradinit, i cili tashmë është aksionari më i madh në klubin e Prishtinës. "Jam që 20 vjet te Prishtina, dikur edhe harxhoresh. 20 vjet kontribut në klubin e Prishtinës nuk janë pak. Arsyja ndoshta mund ta them është se ajo që po ndodh në futbollin e Kosovës nuk më ka rezultuar që ia vlen për momentin të vazhdoj më tutje për arsye se nuk është e lehtë. Ju i shihni edhe klubet e tjera kanë

vështirësi jashtëzakonisht të mëdha. Ne kemi menduar se pas pranimit në FIFA dhe në UEFA do të ketë shumë më shumë lehtësi, por po shohim që po ka më shumë vështirësi. Prandaj, kam vendosur të largohem për një kohë", ka thënë Ejupi, i cili është shpallur nga Klubi Prishtina president nderi në shenjë respekti për kontributin e dhënë përgjatë këtyre viteve.

President i ri do të jetë Rrahman Haradini. Ky i fundit ka thënë se Prishtina është më e madhe se të gjitha ata që kanë qenë, janë dhe që do të vijnë. Ndërsa ka premtuar se do të angazhohet që Prishtina të rikthehet në vendin që e meriton. "Klubi e ka vlerën më të madhe se krejt ata që kanë kaluar, ne që jemi duke kaluar dhe ata që do të vijnë, pra klubi mbetet më i vlefshmi për të gjithë ne. Vullneti ynë ka qenë,



është dhe do të mbetet që ta qesë në binarë, që ta kthejë si i ka hije, që t'ia kthejë klubit reputacionin dhe ku e ka vendin", ka deklaruar

Haradini, i cili më pas ka mohuar se klubi u ka borxh lojtarëve siç është folur në opinion. Prishtina aktualisht është në

vendin e katërt me 9 pikë, një pikë më pak se skuadra e Llapit që zë vendin e parë në Superligën e futbollit.



## Erzen Zyberaj më 28 nëntor do të vrapojë nga Prishtina në Tiranë

PRISHTINË, 21 SHTATOR - Atleti i njohur Erzen Zyberaj ka vendosur që për nder të festës së nëntorit ta sfidojë veten duke vrapuar nga kryeqyteti i Kosovës, Prishtina, në kryeqytetin e Shqipërisë, Tiranë. "Për t'i nderuar festat e nëntorit kam vendosur të sfidoj veten dhe të vrapoj nga Prishtina në Tiranë, një distancë ultramaratonike prej 260 kilometrave. Çdo hap imi përmes këtij vrapimi do t'i nderoj të gjithë ata që sakrifikuin jetën e tyre që ne të vrapojmë dhe festojmë 28

nëntorin në liri. Për ata që nuk patën fatin kurrë të bëjnë këtë rrugë për të parë një herë në jetën e tyre Nanën Shqipni. Për ata të cilët u maltretuan e u përbuzën në tokën dhe rrugët e tyre. Për të gjithë heronjtë dhe heroinat, dëshmorët dhe martirët, luftëtarët dhe invalidët e luftës dhe të paqes. Për të gjithë ata që i shërbyen kësaj toke dhe vazhdojnë ta bëjnë këtë. Për të gjithë shqiptarët që në damarët e tyre u rrjedh gjaku kuqezi", ka thënë Zyberaj.

## Komuna e Lipjanit ndan rreth 85 mijë euro për klubet sportive

LIPJAN, 21 SHTATOR - Rreth 85 mijë euro janë ndarë nga komuna e Lipjanit për klubet sportive, ka njoftuar kryetari i Lipjanit, Imri Ahmeti, në ceremoninë e

nënshkrimit të kontratave. Ahmeti ka shtuar se në janar do të ketë një subvencion tjetër nga komuna e Lipjanit për klubet sportive. "85 mijë e

600 euro, dikujt i duket pak, por sportin nuk mundemi me e përkrah në masën e nevojshme që kërkojnë klubet". Përfitues të këtyre mjeteve ishin klubet e

futbollit "Ulpiana 1996", "Arbëria", "Minatori", klubet e volejbollit "Ulpiana (meshkujt)", "Skënderbeu" dhe Klubi i Atletikës "Blinaja".



## Presidenti i KOK-ut priti ekspeditën e FSPK-së: Sukseset në arenën ndërkombëtare na bëjnë krenarë

**PRISHTINË, 21 SHTATOR** - Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka pritur ekspeditën e Federatës Sportive të Punëtorëve të Kosovës (FSPK), pas suksesit të arritur në Lojërat Botërore Sportive të

Punëtorëve, të mbajtura në Cervia të Italisë. Ekipi i basketbollit 3x3 fitoi medaljen e artë, ndërsa ai i futbollit të vogël medaljen e bronzitë. KOK-u ka njoftuar se presidenti Krasniqi përgëzoi

delegacionin e FSPK-së, duke thënë se çdo sukses i sportistëve tanë në arenën ndërkombëtare na bënë të ndihemi krenarë, sepse kjo tregon se sporti është promovuesi më i mirë i vendit tonë. Në emër të FSPK-së,

nënkryetari Shpend Maxhera e falënderoi presidentin Krasniqi për pritjen dhe mbështetjen e ofruar, duke thënë se sukcesi i ekipeve të tyre u arrit në garën më të madhe botërore të sportistëve amatorë.



## Asllani zhgënjeu në Ligën e Kampionëve, Inzaghi i del në mbrojtje

**MILANO, 21 SHTATOR** - Interi shkëlqeu në derbin ndaj Milanit në fundjavë, shkatërroi rivalët e përjetshëm 5-1, teksa përballë Real Sociedadit vuajti dhe vetëm në fund evitoi humbjen. Kapiteni Lautaro Martinez shënoi tre minuta përpara fundit të takimit, duke i dhuruar skuadrës së Simone Inzaghit barazimin 1-1 në takimin e parë të fazës së grupeve në Ligën e Kampionëve, përballje të cilën Kristjan Asllani e nisi si titullar, por mesfushori shqiptar nuk e shfrytëzoi këtë mundësi. Dhe përballë kundër baskëve nuk zhvilloi paraqitjen që pritej. Asllani dhe Marko Arnautoviç janë përballur me kritika për performancat e tyre kundër Sociedadit. Por, trajneri Simone Inzaghi u doli në mbrojtje dy futbollistëve. "E kisha parashikuar që do të vuanim dhe që do ta kishim të vështirë. U përballëm me një skuadër me vlera. U



treguam të aftë që mbetëm në ndeshje, edhe pse për një orë nuk luajtëm aspak mirë. Pikë e çmuar për ne kundër një skuadre të bukur", theksoi Inzaghi, i cili vijoi edhe zgjedhjet e bëra në formacionin titullar. "Është e lehtë të flasësh pas ndeshjes. Bëra katër ndryshime, sepse ishim të lodhur, edhe pse shkak të impenjimeve të

lojtarëve me kombëtarët e tyre. Faleminderit Sommerit që na ndihmoi me pritjen e tij! Nuk mund t'ua vëmë fajin 2-3 lojtarëve. Të gjithë duhet të bënin më shumë, edhe unë. Mos të harrojmë t'ua japim meritat që u takojnë edhe kundërshtarëve tanë", ka deklaruar trajneri i Interit.

## Rrahmani humb ndeshjen e madhe ndaj Realit

**NAPOLI, 21 SHTATOR** - Kalidou Koulibaly u largua nga Napoli në vitin 2022, Kim në vitin 2023. Krahas tyre ndër vite ka spikatur edhe figura e Amir Rrahmanit, i cili është bërë pjesë e pandashme e Napolit të Spallettit fillimisht dhe më pas e Rudi Garcias. Themelor për mbrojtjen blu, kosovari u largua herët në ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Bragës, e para e kampionëve italianë në sezonin 2023-2024. Shqetësim i madh për napoletanët, duke marrë parasysh se si ky repart në dispozicion të Garcias është i kufizuar: Juan Jesus, Natan, Ostigard dhe askush tjetër. Në minutën e 13 të ndeshjes Braga - Napoli, Rrahmani u largua nga fusha për shkak të një problemi fizik. Stafii mjekësor blu u fut menjëherë në fushë për shkak të një tendosje muskulore në kofshën e majtë. Në ditët në vijim priten kontrole të reja instrumentale. Rrahmani pritet të mungojë për rreth dy-tri javë, duke u rikthyer efektivisht në dispozicion të Rudi Garcia vetëm pas pushimit për



kombëtarët në tetor. Një pengesë e keqe për Napolin, që do të duhet të bëjë pa Rrahmanin kundër Bolognas, Udineses, Lecces dhe Fiorentinës në Serinë A, mbi të gjitha në ndeshjen e Ligës së Kampionëve kundër Real Madridit, të planifikuar për më 3 tetor në "Diego Armando Maradona". Sipas asaj që kemi parë

në këtë start të sezonit të ri, Ostigard është zëvendësuesi i Rrahmanit për të luajtur përkrah Juan Jesus. Natan, i cili erdhi në verë pas largimit të Kim, nuk ka startuar ende me Rudi Garcia. Edhe në Ligën e Kampionëve, sapo shoku i tij i skuadrës u largua, ishte Ostigard ai që u zgjodh nga bankina.

### SHKURT

#### KB Trepça përforcohet me amerikanin Manderson

KB Trepça, që në fundjavën që shkoi e fitoi Superkupën e Kosovës në basketboll, të enjten është përforcuar me Isaiah Manderson. Qendra amerikane edicionin e fundit ishte pjesë e Puerto Rico Carolina, kurse në të kaluarën ka luajtur edhe për Rahovecin. "Kompletojmë transferimin e Isaiah Manderson. Plus (208 centimetra) në ekip. Kemi angazhuar qendrën amerikane Isaiah Manderson. Manderson i bashkohet Trepçës nga Puerto Rico Carolina, derisa në edicionin e kaluar Manderson ka luajtur në Superligën e Kosovës, duke u paraqitur te Rahoveci", ka njoftuar klubi mitrovicës.

#### Shaqiri ndëshkohet me karton të kuq në humbjen e Chicago Fire

Sulmuesi shqiptar i Chicago Fire, Xherdan Shaqiri, është ndëshkuar me karton të kuq në ndeshjen e fundit të ekipit të tij në Mayor League Soccer. Chicago Fire u mposht me rezultat të pastër 3-0 nga Columbus Crew në ndeshjen e vlefshme për konferencën lindore të MLS. Megjithatë, kjo nuk ishte e tëra për klubin nga Çikago, pasi në ndeshjet e ardhshme do të ketë një mungesë të madhe. Bëhet fjalë për yllin shqiptar Shaqiri, i cili u ndëshkua me të kuq në minutën e 67 të ndeshjes. Shaqiri mori kartonin e dytë të verdhë pas një ndërhyrje të rrezikshme ndaj kundërshtarit të tij Rudy Camacho. Kapiteni i Chicago Fire kartonin e parë të verdhë e kishte marrë në minutën e 44-t.

#### Onana: Faji për humbje është i imi

Portieri i Manchester Unitedit, Andre Onana, nuk e ka nisur aspak mirë aventurën te Manchester United, duke bërë disa gabime trashanike. "Djajtë" humbën ndeshjen e parë të Grupit A në transfertë 4-3, teksa e pësuan golin e parë ndaj Bayern Munchenit pas gabimit të ish-portierit të Interit. "E pranoj fajin dhe përgjegjësinë e golit të parë. Sigurisht që mund të kisha bërë më mirë, por tashmë nuk ka vlerë asnjë diskutim rreth kësaj teme. Nëse nuk do të ishim penalizuar prej atij rasti, rezultati nuk do të ishte negativ për ne. Unë prisja balancat e më pas dha ndikim te loja", ka thënë Onana.

#### Sane për gabimet në mbrojtje: Duhet t'ua japim fund

Leroy Sane ishte lojtari i ndeshjes në sfidën e Ligës së Kampionëve mes Bayern Munchenit dhe Manchester Unitedit. Futbollisti gjerman ka thënë se të gjithë janë të lumtur për fitoren e arritur, po atij nuk i kanë pëlqyer aspak gabimet që rezultuan me pranimin e tri golave. "Jemi të lumtur për këtë fitore në sfidën e parë të Ligës së Kampionëve. Ishte një lojë e fortë. Ishim mirë përpara, por duhet të ndalojmë së bëri kaq shumë gabime. Ishte pa diskutim një sfidë spektakolare për tifozët, por jo për ne. Duhet të jemi më të qetë dhe më të saktë në kundërsulm", ka thënë Sane.

## Joao Felix: Sakrifikova pagën time që të vija në Barcelonë

Joao Felix pati një ndikim të shkëlqyer te Barcelona, me tri gola në tri ndeshje dhe dy në debutimin e tij në Ligën e Kampionëve. Sulmuesi portugez

shpreson ta shpaguajë veten me fanellën blaugrana pas sezoneve të vështira tek Atletico Madridi. "Sakrifikova një pjesë të rëndësishme të

pagës sime, por më duhej të ndryshoja, të shkoja në një vend ku mund ta ushtroja futbollin tim. Xavi më kërkoi të bëj punë taktike, por tani po

argëtohem", ka thënë ai në një intervistë për "Mundo Deportivo". "Nëse je i sëmurë, duhet të ndryshosh. E bëra më parë me Chelsea, e bëra tani

me Barcelonën, sepse nuk isha mirë. Nuk u përshtata me idetë e klubit dhe trajnerit, por gjithmonë jam përpjekur të bëj më të mirën", ka shtuar Joao Felix.



## SHPLLJE E VENDIT TË LIRË TË PUNËS

**Titulli i punës/Pozita:** Auditor-e i/e Lartë i/e Teknologjisë Informative

**Departamenti/Divizioni:** Departamenti i Auditimit të Brendshëm

**Niveli i gradës:** 4

**I raporton:** Drejtorit të Departamentit të Auditimit të Brendshëm

### Qëllimi dhe fushëveprimi i pozitës:

Auditori/ja i/e Lartë i/e Teknologjisë Informative (TI) kryen auditime të teknologjisë informative, të pajtueshmërisë, auditimin e Menaxhmentit, si dhe hulumtimet paraprake të aktiviteteve të caktuara operative dhe funksionale në përputhje me Statutin e Auditimit të Brendshëm, si dhe bën vlerësimin e efektshmërisë së kontrolleve të brendshme të këtyre aktiviteteve.

Auditori/ja i/e Lartë i/e Teknologjisë Informative punon nën mbikëqyrje të drejtpërdrejtë të Drejtorit/Drejtoreshës të Departamentit të Auditimit të Brendshëm të BQK-së.

### Fushëveprimi i punës për këtë pozitë është si në vijim:

- Auditimet e brendshme;
- Sistemet dhe procedurat dhe çështjet tjera administrative;
- Trajnimi dhe zhvillimi.

### Përshkrimi i Detyrave dhe përgjegjësi:

#### Auditimet e Brendshme:

- Në bashkëpunim me mbikëqyrësin/es merr pjesë në hartimin e planit të auditimit dhe miraton planet e punës dhe afatet për kryerjen e auditimeve dhe shërbimeve tjera përkatëse;
- Kryen auditime të brendshme, zhvillon intervista me stafin (personelin), merr dhe analizon dokumentacionin përkatës në përputhje me objektivat e BQK-së dhe në linjë me Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e Auditimit të Brendshëm, etj;
- Kryen auditime të rregullta apo me kërkesë, mbi përdorimin efektiv të resurseve të BQK-së, përpilon draft-raporte, diskuton rezultatet me mbikëqyrësin dhe auditorët e brendshëm, si dhe harton raportet finale mbi angazhimin e tij/saj;
- Merr pjesë aktivisht në diskutime me auditorët e brendshëm, finalizon dosjen e auditimit dhe monitoron zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga Auditimi i Brendshëm dhe Auditorët e Jashtëm;
- Ofron këshilla për çështje të auditimit dhe Teknologjisë Informative, sipas nevojës;
- Zbaton Ligjin e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, Statutin e Auditimit të Brendshëm, Manualin e AB-së, Kodin e Etikës, si dhe të gjitha aktet tjera me të cilën rregullohet fushëveprimaria e auditimit të brendshëm.

#### Sistemet/procedurat dhe çështjet administrative:

- Kryen shqyrtimet e pavarura të sistemeve ekzistuese apo të propozuara nëpër të gjitha entitetet e BQK-së (departamentet, divizionet, si dhe fushat tjera relevante) duke propozuar dhe ndikuar në përmirësimin e tyre;
- Vlerëson efektshmërinë dhe efikasitetin e të gjitha sistemeve të rëndësishme të kontrollit të brendshëm të teknologjisë informative, monitoron performancën, propozon dhe ndikon në përmirësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm;
- Teston operimet e sistemeve të teknologjisë informative në BQK, besueshmërinë dhe tërësinë e informatave, si dhe transaksionet e gjeneruara sipas ligjeve, politikave, procedurave, planeve dhe rregulloreve me të cilat qeveriset BQK-ja;
- Jep kontribut përgjatë përgatitjes së Planit vjetor të punës së Auditimit të Brendshëm;
- Kryen punë administrative sipas nevojave të Drejtorit/Drejtoreshës të DAB-it, apo vetë departamentit.

#### Trajnimi dhe zhvillimi:

- Të ketë gatishmëri për të marrë pjesë në trajnime relevante për auditime të brendshme dhe të Teknologjisë së Informacionit, si dhe të ofroj ndihmën e duhur për pjesën tjetër të punonjësve në Departamentin e Auditimit të Brendshëm;
- Të dëshmojë se ai/ajo është duke i zhvilluar aftësitë e tij/saj në dobi të Bankës Qendrore dhe Departamentit të Auditimit të Brendshëm, brenda saj.

#### Njohuritë e kërkuara:

- Diplomë universitare në fushën e ekonomisë apo fushat relevante të Teknologjisë Informative;
- Së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale në fushën e Teknologjisë Informative apo në fushën e auditimit (përvoja në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Çertifikatë profesionale në fushën e Teknologjisë Informative ose auditimit të brendshëm (çertifikata në fushën e auditimit të Teknologjisë Informative konsiderohet përparësi);
- Njohuri mbi fushat e ndryshme të teknologjisë informative si: zhvillimi i softuerit, sistemet operative, menaxhimi i data bazës, dhe rrjeta;
- Njohuri mbi kornizën dhe standardet si COBIT, ISO 27001, ITIL, etj;
- Shkathësi të shkëlqyeshme organizative, të planifikimit dhe të menaxhimit të kohës;
- Shkathësi të shkëlqyeshme ndër-personale dhe të komunikimit, si dhe aftësi në zgjidhjen e konflikteve;
- Saktësi, vëmendje në detaje dhe ndjeshmëri ndaj prioriteteve;
- Njohuri të shkëlqyeshme të përdorimit të aplikacioneve softuerike të pakos MS Office;
- Të ketë njohuri të rrjedhshme të gjuhës shqipe dhe/ose serbe në të folur dhe të shkruar (Gjuha angleze e preferueshme);
